2.3.18 Cdo operator pjesmarres në tender ose grup operatoresh duhet te këtë një përvojë të suksesshme te se njejtës natyre aktiviteti me ate qe prokurohet jo me pak se 5 vite si dhe pa shkeputje te ushtrimit te aktivitetit te saj nga prokurimet publike qe nga Regjistrimi i saj e ne vazhdim, te kete realizuar kontrata te se njejtës natyre me institucione shtetore shoqeruar me vertetim realizimi per sejcilin vit 2015-2016-2017 nje ose me shume kontrata deri ne 40% te fondit limit qe prokurohet.


2.3.19 Kualifikimi përfundimtar i cdo operatori te kualifikuar ne tender ose bashkim operatoresh (secili ne menyre individuale) do te behet pasi te behet nga KVO kontrolli fizik i te gjitha specifikimeve teknike te mesiperme

2.3.20 Me qellim verifikimin e aktivizimit te mjeteve, fuqise punetore, te kerkuara ne kerkesat e vecanta te kualifikimit per cdo lot, Operatori Ekonomik pjesmarres duhet te paraqese nje deklarate ne te cilen do te pasqyroje te gjitha kontratat e lidhura apo ne proces lidhje kontrate, me Institucione te tjera Shtetore per vitin 2018.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorezimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Me qëllim verifikimin e aktivizimit të mjeteve, fuqisë punëtore, të kërkuara në kërkesat e vecanta të kualifikimit për çdo lot, Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë në të cilën do të pasqyrojë të gjitha kontratat e lidhura apo në proces lidhje kontrate, me Institucione të tjera Shtetërore për vitin 2018,

I gjithë informacioni i paraqitur do të verifikohet nga AK (QEZHEF). Pas verifikimit, të gjitha kapacitetet e kërkuara në kriteret e vecanta të kualifikimit si: mjetet (ATV, ATP), fuqia punëtore të cilat janë angazhuar në kontratat e paraqitura në deklaratë, nuk do të njihen si kapacitete për përmbushjen e atyre të kërkuara nga ana jone në DST.



Public Health Sector

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqesuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula



Public Health Sector

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Per te realizuar kontraten e furnizimi me artikujt e mesiperm operatori ekonomik duhet te kete parasysh keto specifikime si me poshte:

BUKE;Korja :e lemuar,pa flluska,pa carje e pjese te djegura dhe pa shkeputje te saj nga tuli.Me ngjyre te njellojte mjalti ne te kuqerremt.Tuli:mase e njellojte e pjekur mire,jo e ngjitshme me pofre te shperndara ne menyre te njetrajtshme dhe pa gjurme mielli te pa brumosur.Kosinsisenca elastike me shtypje te lehte rikthehet ne gjendjen e pare ,jo I thermueshem dhe pa shtresa.Era dhe shija:e kendshme e bukes se pjekur mire.Pa ere e shije te hidhur,te tharte,myku ose te huaj.Nuk lejohet kercitje.Forma:e rregullt pa shtypje e deformime.Lendet e huaja:Te mos kete lende te huaja qe te prishi treguesit organo-leptik.Treguesit e organit leptik,pa ere myky te tharte ose te huaj,lageshtira jo me shume se 40%,proziteti jo me pak se 70%.Transporti I bukes behet me mjete te pastra te mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

Lloji:Mish vici I fresket cilesia e pare;**Kerkesat cilesore:**Pamja e jashtme:siperfaqja e mishit eshte e mbuluar me nje cipe te holle te thate .Siperfaqja e mishit pas prerjes eshte e lagur dhe e ndritshme,lengu del me veshtiresi dhe eshte I tejdukshem.Tendinat jane te shndritshme elastike dhe te forta.Te mos kete lende te huaja qe prishin treguesit organo-leptik.

Ngjyra:Mishi I vicit ka ngjyre roze e ndryshme nga lopa qe ka ngjyre te kuqe dhe kau me ngjyre te kuqe te mbyllur.Ne prerje siperfaqja eshte e ndritshme,ngjyra e dhjemit eshte e bardhe tek kafshet e reja ndersa tek kafshet e rritura eshte e verdhe.Era:e kendshme,karakteristikat e llojit.Ambalazhimi dhe marketimi:Cdo gjysem trup e cerek damkoset me vulen e kontrollit veterinar dhe me vulen e llojit e te cilesise se mishit.Cdo parti mishi shoqerohet me certificate veterinare..Tregetimi I mishit te fresket behet jo me pare se 6 ore nga koha therjes ne vere ,ndersa ne dimer 12 ore.

Mish pule cilesia e pare;Cilesi e pare,shoqeruar me certificate veterinare te prodhuesit dhe analizen fiziko-kimike-periodike.Ngjyra:Ngjyra e mishit te jete e paster.Era:e kendshme,karakteristike e llojit.Ne siperfaqen e tij te mos kete pjese te demtuara ose te prishura.Te jete I pajisur me date skadence ne paketim.Malli te jete I ambalazhuar ne ambalazh plastic e mbeshjtjelle me qetesi celofani,cdo njesi te jete etiketuar.Shenim:Prodhimet e mesiperme duhet te jene te kontrolluara e te vulosura me vulen e mjekut veterinary,te jene te siguruara nga semundja e “lopes se cmendur”,”bruceloza”etj.dhe semundjet e tjera infective,si gripi I shpendeve etj.

1.QUMESHT :

Lloji:Te jete qumesht I fresket cilesia e pare.Ngjyra:E bardhe ne te verdhe e njellojte ne te gjithë siperfaqen.Era dhe shija:e kendshme karakteristike e qumeshtit.Pamja e jashtme:Homogjene ne te gjithë sasine e lengut.Ambalazhimi:Qumeshti te jete I amaballazhuar ne kuti kartoni hermetike me afat perdorimi 7 dite,nga dita e marjes ne dorezim.Ne ambalazhim te shenohen emri prodhuesit ,emertimi produktit,masa neto,data e prodhimit,afati I perdorimit.Transporti:Do te behet me mjetet e shitesit deri ne magazinat e bleresit.Dorzimi mallit:Do te behet prane magazines se bleresit me fature tatimore shitje.Malli te shoqerohet me flete analize.Verifikimi cilesor: Do te kryhet nepermjet kontrollit organo leptik dhe flete analizes.

2.Kos

Stazh 1443-87;Lloji:te jete I fresket cilesia e pare.Ngjyra:Ebardhe ne te verdhe e njellojte ne te gjithë siperfaqen.Era dhe shija:E kendshme,karakteristike e kosit.Pamja e jashtme:homogjene ne te gjithë sasine e lengut.Amballazhimi: Te jete I amballazhuar ne kuti plastike , amballazhimi sipas kerkeses se autoritetit kontraktor.Ne amballazh te shenohet emri I prodhuesit,data e prodhimit,afati I perdorimit.Transporti:Do te behet me mjetet e shitesit deri ne magazinat e bleresit.Dorzimi mallit:Do te behet prane magazinanes se bleresit me fature tatimore shitje.Malli te shoqerohet me flete analize.Verifikimi cilesor:Dote kryhet nepermjet kontrollit organo leptik dhe flete analizes.

3.GJALPE:STASH1455-87.Lloji:Te jete gjalpe I fresket cilesia e pare.Pamja:E njetrajtshme,pa shtresa ne prerje,me siperfaqe te shndritshme pa pika uji dhe mbeturina dhalli.Ngjyra Krem deri ne te verdhe te celur.Era dhe shija;Te kete ere dhe shije karakteristike te gjalpit pe ere dhe shije te huaj.Konsistenca Ne temperature 10-12 grade te jete gjysem I forte.Data prodhimit/Data skadimit/Transporti Do te behet me mjetet e shitesit deri ne magazinat e bleresit.Dorzimi I mallit Do te behet prane magazines se bleresit me fature tat.shitje.

2.MAKARONA:STASH 1170-87/Lloji Makarona te thjeshta./Treguesit Organo-shqisor:/Forma forme te gjatame gjat,30 cm nr 6.Pamja:Te jene me forme te rregullt,te plota,me siperfaqe te lemuar deri lehtesisht te ashpra, mbas zierjes te jene elastike,te mos qullosten,te mos cahen e te mos krijojne shkume./Ngjyra:e bardhe me nuance te verdhe./Era dhe shija: E mire karakteristike e makaronave ,pa shije te hidhur,te tharte,te mykur dhe cfaredo ere dhe shije tjeter te huaj.

Amballazhimi:Makaronat te jene te amballazhuara ne mase 0.5kg,te paketuara ne kuti kartoni.Etiketa duhet te fiksohet qe te mos shkeputet.Shenimet duhet te jene te qarta e lehtesisht te lexueshme.Emri prodhuesit duhet te jete I dallueshem./Markerimi:Emertimi I prodhuesit/Emri produktit/Pesha neto/Data prodhimit/Data skadimit/Transporti:Te behet me mjeket e shitesit deri ne magazinat e bleresit./Dorzimi I mallit:Do te behet prane magazines se bleresit me fature tatimore shitje./

3.VAJ USHQIMOR;STASH 203-2002/Lloji:Vaj ushqimor luledielli I rafinuar/Treguesit Organo-shqisor/Pamja:Leng vajor I qarte pa depozitime/Ngjyra: e verdhe e lehte..Era dhe shija:Karakteristike e vajit te lulediellit,pa shije dhe ere te huaj te ranciduar./Amballazhimi:Vaji te jete I amballazhuar ne shishe plastike me vellim 1-5 litra me tape plastike me vidhezim te kapsuluara me shirit PVC me stampen perkatese,te sistemuara ne kuti kartoni./Etiketa duhet te jete e fiksuar./Markerimi:/-Emertimi produktit./-Emri prodhuesit/-Lenda e pare per prodhimin/-Data e prodhimit./-Data e skadimit./Transporti:Te behet me mjetet e shitesit deri ne magazinat e bleresit./Dorzimi I mallit:Do te behet prane magazines se bleresit me fature tat.shitje.

4.SHEQER ;STASH 1413-87.Lloji :Sheqer/Treguesit organo-shqisor/Pamja:pluhur I paster I perbere nga kristale te imeta dhe te njellojta,pa copa sheqeri te ngjeshura ose lende te huaja.Te jete I thate ne te prekur dhe te mos ngjitet.Ngjyra:E bardhe dhe me shkelqim/Era dhe shija:Shije te embel,pa shije dhe ere te huaj/Tretshmeria:Tretet plotesisht ne uje,tretesira eshte etejdukshme dhe pa ngjyre/Amballazhimi:Sheqeri te jete I amballazhuar ne pako 1 kg.Etiketa duhet te jete e stampuar ne amballazhim.Shenimet duhet te jene te qarta e te lexueshme.Markerimi:-Emertimi prodhuesit/-Emri produktit/-Pesha neto/-Data prodhimit./-Data skadimit./Transporti:Do te behet me mjetet e shitesit, deri ne magazinat e bleresit./Dorzimi I mallit:Do te behet prane magazines se bleresit me fat.tat.shitje.

5.KRIPE; STASH:1656-/87./Lloji:Te jete kripe e bardhe ushqimore e perpunuar dhe e bluar per perdorim ne kuzhine,e jodizuar cilesia e pare./Treguesit organo-shqisor./Pamja:Kripe me mase kokrrizore ne ngjyre te bardhe./Era dhe shija:te kete ere dhe shije normale,pa ere dhe shije te huaj./Amballazhimi:Te jete I amallazhuar me qese 0.5kg.Dorzimi I mallit:Do te behet prane

magazines se bleresit me fature tat.shitje./Amballazhimi:Kripa te jete e amballazhuar ne qeska 0.5kg ne amballazh te jene shenuar emery I prodhuesit,lloji I prodhimit,data prodhimit,masa neto.Transporti:Te behet me mjetet e shitesit deri ne magazinat e bleresit./

6.SALCE; STASH1429-87/Lloji:Salce domate cilesia e pare./Era dhe shija:Te kete ere dhe shije normale te salces domates pa ere dhe shije te huaj.Pamja:mase e njetrajtshme jo fibroze.Ngjyra:E kuqe intensive karakteristike e salces.Amballazhimi:te jete e amballazhuar ne kuti metalike me mase 1 kgderi ne 5 kg.Ne amballazh te jene te shenuar emri prodhuesit,data e tij,masa neto.Dorezimi I mallit:Do te behet prane magazines se bleresit me fat.tat.shitje.Transporti:Te behet me mjetet e shitesit deri ne magazinat e bleresit.

7.Recel frutash,kumbulle/qershie ; Amballazhimi te jete me amaballazh plastic me mase 5 kg.Ne amballazh te vendoset etiketa ku shenohen ndermarja prodhuese,lloji,data e prodhimit/Era dhe shija te kete ere dhe shije normale pa ere myku ose shije tjeter te huaj,te tharte /Dorezimi imallit do te behet prane magazines se bleresit me ftsh/TransportiTe behet me mjetet e shitesit derine magazinat

1.VEZE:

STASH 1515-85;Lloji:VEZE PULE/Pamja e jashtme:E paster,pa plasje,lejohen ndotje te lehta/E bardha e vezes:e dendur,e kulluar,e paster dhe pa njolla gjaku/Everdhja e vezes:Kompakte e ndodhur ne pozicionin qendror pak e levizhme.Etiketimi:Te jene te vulosura ne siperfaqe me vulen perkatese te prodhuesit/Era dhe shija Pa ere dhe shije te huaj/Masa Jo me pak se 40gr/Amballazhimi te jene te vendosura ne bikurina e te sistemuara ne arka kartoni./Dorezimi I mallit:Do te behet prane magazines se bleresit me fat.tat.shitje./Transporti te behet me mjetet e shitesit deri ne magazinat e bleresit

FASULE; STASH 1743-87/Lloji:Fasule te that ate bardha. Treguesit organo-leptik(shqisor)/Pamja e jashtme te jene kokrra te plota,te shendosha,me formed he madhesi mesatare sipas llojit./Era dhe shija:Pa ere myku ose cfaredo ere tjeter te huaj,pas zierjes te kete kendshme,pa shije te hidhur ose cfaredo shije tjeter.Ngjyra e bardhe/Amballazhimi:Fasulet te jene te amballazhuara ne thase te paster,te thate.te dizinfektuar dhe pa ere te huaj.Thaset te jene standart 50kg.Etiketa duhet te fiksohet ne menyre qe te mos shkeputet nga amballazhi.Shenimet duhet te jene te dukshme dhe lehtesisht te lexueshme.Emri I produktit duhet te bjere ne sy ne pamje te pare.Markerimi:Emertimi prodhuesit/Emri produktit/Pesha neto/Data e prodhimit/Data e skadimit/Transporti Do te behet me mjetet e shitesit deri ne magazinat e bleresit./Dorezimi I mallitDo te behet prane magazines se bleresit me fature tat.shitje.

3.PATATE;STASH1729-88/Lioji Patate verore e dimerore/Pjekuria Kokrra te pjekura/Pamja e jashtmeTe jene te plota,te forta,te pastra,te thata,jo jeshile,jo te mbira me sytha.Nuk lejohen jeshile,te vyshkuar,te mbira,te cara./Amballazhimi Te jene te amballazhuara ne thase te paste rose rrjeta plastike me peshe deri ne 50 kg./Transporti Do te behet me mjetet e shitesit ne kushte te mira higjeno sanitare/Verifikimi cilesor Do te behet nepermjet kontrollit organo shqisor te mallit.Madhesia e kokrres Per veroret mbi 4 cm dhe per dimroret mbi 5cm

4.Qepe e thate Pamja e jashtme Me pjekuri te plote ,me cipe bisht te thate ,te shendosha e te plota me ngjyre e forme tipike te kultivarit me gjatesi te bishtit deri 7 cm.Madhesia e kokrres – Per ovalet 4-8cm -per te tjerat 5-10cm/Nuk lejohen te ngrira,te kalbura,te mykura me semundje./Amballazhimi te jene te amballazhuara ne vargje,thase ose rrjeta plastike./Transporti Te behet me mjetet e shitesit/Verifikimi cilesor:Te behet nepermjet kontrollit organo-leptik

5.PERIME:(domate,specat,transgjen,biote,patellxhan,presh,lakerr,sallate jeshile,spinaq,bamje,etj)
a.Domate:Stash 1726-88,1799-88/Lloji:Domate per treg cilesia e pare/Pamja e jashtme:Te

fresketa me forme tipike te kultivarit,te plota,te pastra,te pavarura,te pashtypura,pakalbje,pa njolla,te paprekura nga semundjet dhe demtuesit.Pjekuria dhe ngjyra:Me pjekuri normale,me ngjyre te kuqe,lehtesisht roze dhe jeshile rreth bishtit.Nuk lejohen domate te tejpkjeka, te zbutura e te vyshkura.Demtime e semundje:Nuk lejohen/Madhesia e kokrrës:Per te mesmet 5 cm(diameter gjerësor)Per te vonat 7 cm,Kumbullore gjat.5 cm/b.Speca stash1756-88/Lloji:spec per treg cilesia e pare/Pamja e jashtme:Me ngjyre e forme tipike te kultivarit ,te fresketa,te pastra dhe me pjekuri teknike.DemtimeTe shtypura,te gervishtura jo me shume se 3%/Shija:Karakteristike e kultivarit,lejohet shije djegese e lehte.Nuk lejohet perzierje e specave djegese me ato te tjere.Gjatesia:Per te gjatat mbi 10 cm.Per te rrumbullaktat mbi 7 cm/c.Bizele kokerr:Stash 1713-88/Lloji:Bizele per treg cilesia e pare/Pamja e jashtme:te njoma,te fresketa,te pastra,te pacara,me ngjyre te kultivarit,me pjekuri teknike dhe madhesi normale te kultivarit/Demtime mekanike:Njolla ndryshku,ndeze e kalbje nuk lejohen.d.Presh:stash 1759-88/Lloji:Presh per treg cilesia e pare/Pamja e jashtme:I fresket,I paster,I njome,me ngjyre te bardhe,I pavyskur dhe I lare me uje te pijshem/Demtime e semundje:Nuk lejohen/

4.DJATHE I BARDHE ; STASH 1492-87../Lloji:Djathe I bardhe gjysem I forte cilesia e pare.Pamja e jashtme:E paster dhe pa te meta ne sipërfaqe,ne perje duken sytha teknike.Era dhe shija:Te kete ere dhe shije te kendshme karakteristike e djathit te stazhionuar,pa shije te hidhur dhe arome te huaj.Forma dhe masa:Forme sektori,kubi,paralelopipedi.Masa 3-4 kg/Konsistenca:E lemuar jo e forte dhe pa dallim shtresash.Te mos thermohet gjate prerjes ne racione te vogla deri ne 40 gr./Ngjyra e bardhe ne krem/Amballazhimi Te jete I amballazhuar ne fuci kaucuku deri 50 kg te zhytur teresisht ne shellire me permbajtje 10-14%kripte. Ne amballazhim te shenohen emri I prodhuesit,emertimi produktit,masa neto,data e prodhimit,data e skadences.Transporti:Do te behet me mjetet e shitesit/Dorezimi I mallit:Do te behet prane magazines se bleresit me fature tat.shitje.Malli te shoqerohet me certificate analize.Verifikimi cilesor.Do te behet nepermjet kontrollit organo leptik dhe fl.analizes

1.ORIZ;STASH 1738-87 ose 1738-84,1451-85/Lloji Orizi I zhveshur cilesia e pare/Treguesit organo-shqisor/Pamja:Te jene kokrra te pastra,te zhveshura teresisht nga levozhga e orizit,pa shenja myku ose prishje/Ngjyra E bardhe,te lejohen kokrra me nuance ne ngjyre te kuqe ose te verdhe./Era dhe shija:Karakteristike e orizit te shendoshe ,pa shije te tharte,te hidhur,pa ere myku dhe cfaredo ere tjeter te huaj.Nuk lejohen demtues hambari,lende minerale,kokrra te pazhvilluara ose te mykura.Amballazhimi:Orizi te jete I amballazhuar ne qese nje kg.Etiketa e produktit duhet te jete stampuar ne amballazhimin e orizit.Markerimi./Emertimi prodhuesit./Emri produktit./Pesha neto./Transporti I perimeve:Behet me mjete te pastra te mbrojtura nga demtime e fatore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.Furnizimi me qumesht,veze dhe perime te behet cdo dite.Furnizimi me produktet e tjere te behet sipas kerkeses se autoritetit kontraktues.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Ushqime Koloniale				
Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	
1	Vaj gjelle	litra	590	
2	Vaj ulliri	litra	20	
3	Oriz	kg	830	
4	Makarona	kg	650	
5	Sheqer	kg	340	
6	Gjalp	kg	250	
7	Salc e kuqe	kg	140	
8	Miell	kg	30	
9	Fasule	kg	50	
10	Sode buke	pako	20	
11	Krip	kg	128	
12	Uthull	cope	40	
13	Leng Limoni	cope	40	
14	Piper I zi	pako	24	

Ushqime Blektoriale				
1	Mish Vici	kg	650	
2	Kofsha Pule	kg	750	
3	Djath i bardhe	kg	550	
4	Veze	kokrra	16060	
5	Djath kackavall	kg	250	
6	Qumesht	litra	2868	
7	Kos	litra	2868	

Perime				
1	Patate	kg	1200	
2	Qepe	kg	250	

3	Presh	kg	150		
4	Koklaker	kg	50		
5	Spinaq	kg	120		
6	Karota	kg	30		
7	Bizele	kg	50		
8	Qep te njoma	kg	40		
9	Hudhra	kg	3		
11	Majdanoz	doreza	200		
12	Barbunja	kg	50		
13	Speca	kg	100		
14	Paterxhane	kg	100		
15	Domate	kg	40		
16	Sallator	kg	20		
17	Kungull	kg	150		
18	Bamje	kg	20		
19	Moll	kg	20		
20	Portokalle	kg	20		
21	Mandarina	kg	20		

Buke					
1	Buke	kg	5800		

Afatet e lëvrimit: nga nënshkrimi I kontrates deri me 31 .12.2017

Public Health Sector

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Shërbim: Mall: Punë: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Public Health Sector

Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>



Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Public Health Sector

Me respekt
< Emri >

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.


Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]



Public Health Sector

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokurara me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjatë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

“kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Entit prokurues dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot, dhe rrisqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktor.

“Lëvrimi ” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

“Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

“Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.

“palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

“Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gazshme.

“Shërbimet në Lidhje me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.

“objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet në Lidhje me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

“Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korrupsive. Veprimet korrupsive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikatat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake më shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron materialet.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Pershtatshmeria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në perputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në pajtim me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Pershtatshmeria e Mallrave me Standartet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standarteve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet perkatese ose në Standartet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër të kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standart Teknik perkates në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike ndërkombëtare të tanishme. Nëse nuk egzistojnë Standarte Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike perkatese Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktues me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të pronës (Mallrave) për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqsimin e reklames së shitësit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse kontrata parashikon, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e dhëna një sasi pjesësh këmbimi, në akordim me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë perkatese të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetgjatësinë e përdorimit të Mallrave.

- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor në kohë të mjaftueshme për të lejuar Autoritetin Kontraktor të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë gratis Autoriteti Kontraktor nëse ai kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe pakeluar në pajtim me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe pakeluar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës.
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspekte shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të bie dakort të ndryshojë grafikun e levrimit.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Mallrave nuk do ta clirojë Kontraktuesin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 13: Kushtet e Dorëzimit

